

VENDIM
Nr. 938, datë 4.11.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR TË
NDËRMARRË DHE ZHVILLUAR PROCEDURAT PËR DHËNIEN ME
KONCESION/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT TË SHËRBIMIT PËR
PRODHIMIN E SHPËRNDARJEN E DOKUMENTEVE BIOMETRIKE TË
IDENTIFIKIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr.125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shërbimi për prodhimin e shpërndarjen e dokumenteve biometrike të identifikimit të jepet me koncesion/partneritet publik privat.
2. Përcaktimin e Ministrisë së Brendshme si autoritet kontraktues për të ndërmarrë e zhvilluar procedurat për dhënie me koncesion/partneritet publik privat të shërbimit për prodhimin e shpërndarjen e dokumenteve biometrike të identifikimit.
3. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe